



Duke u bazuar në nenin 43, 45 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, Nr.03/L-040, nenin 47 të Statutit të Komunës së Klinës Nr. 01-110-1232/2010. Nenin 5 të Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës si dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës bën këtë:

F T E S Ë

Ftohën të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe të interesuarit e tjerë që të marrin pjesë në seancën e **VII-të të rregullt të punës së kuvendit për vitin 2023**. Seanca mbahet më **28.07.2023 (e Premte)**, në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe fillon në **orën 10:00**.

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së. Për këtë seancë propozohet ky:

R E N D I I D I T Ë S:

1. Arsytimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimeve të Komitetit për Politik dhe Financa,
4. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar-qershor 2023 (ref.drejt.fin),
5. Shqyrtimi i raportit të auditimit të jashtëm për vitin 2022 (ref. ekz),
6. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorëve të jashtëm (ref.ekz),
7. Shqyrtimi i procesverbalit nga takimi i parë me qytetar i mbajtur nga kryetari i komunës me datë: 26.06.2023,
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake (ref. drejt.fin)
9. Rishqyrtimi i vendimit 01Nr.06-18045/23 sipas shkresës së MMPHI-së me nr.2943-3/23 e datës 04.07.2023,
10. Pyetje dhe përgjigjeje.

01Nr. 06-23437 2023
Klinë, me 17.07 2023





Na osnovu člana 43, 45. i 47. Zakona o lokalnoj samoupravi, br. 03/L-040, člana 47. Statuta opštine Klina br. 01-110-1232/2010, člana 5 Administrativnog uputstva MAPL br. 02-2015 za održavanje sednica skupštine opštine kao i člana 4 Pravilnika o radu Skupštine i opštinskih komiteta, predsedavajući Skupštine opštine vrsi sledeće:

OBAVEŠTENJE

Obaveštavaju se svi odbornici Skupštine opštine Klina i lokalni mediji da učestvuju **VII-m redovnom sastanku skupštine za 2023 godinu.**

Sastanak se održava 28.07.2023 (Petak), u sali Skupštine opštine Klina sa početkom u 10 časova.

U vezi sa pitanjem neučešća na raspravi, pozvati se na odredbu člana 39 ZLS.

Predloženi:

DNEVNI RED

1. **Obrazloženje izostanaka,**
2. **Razmatranje i usvajanje zapisnika sa prethodnog sastanka,**
3. **Razmatranje i usvajanje preporuka Političkog i Finansijskog Komiteta,**
4. **Razmatranje izveštaja o finansijskom upravljanju za period januar-jun 2023. godine (ref. direct.fin),**
5. **Razmatranje izveštaja vanske revizije za 2022. godinu (ref. opština.),**
6. **Razmatranje akcionog plana za sprovođenje preporuka eksternih revizora (ref. opština.),**
7. **Razmatranje zapisnika sa prvog sastanka sa građaninom koji je održao predsednik opštine 26.06.2023.**
8. **Razmatranje i davanje saglasnosti na predlog-odluke o prenosu sredstava iz sopstvenih prihoda (ref. fin.)**
9. **Razmatranje rešenja 01 br. 06-18045/23 po dopisu MSPPI br. 2943-3/23 od 04.07.2023.**
10. **Pitanja i odgovori**

01Br. 06-23437 2023
Klina, 17.07 2023





Për/To/Za :	Kuvendin Komunal, Klinë
Nga/From/Od :	Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim - z. Enver Berisha
Përmes/Through/Preko :	z. Zenun Elezaj – Kryetar i KK- Klinë
Tema/Subjekt/Subjekat:	Kërkesë për bartje të mjeteve të mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2021, fondi 22 i vitit 2022, në vitin 2023
Data :	

Të nderuar,

Të hyrat vetanake të vitit 2021, fondi (22) i vitit 2022, të cilat do të barten në vitin 2023 janë në shumën prej 346,194.57 €. Sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave Ligjit të buxhetit për vitin 2023 dhe Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nga teprica e mjeteve nga viti paraprak që barten në vitin vijues paguhen obligimet nga viti paraprak sipas kontratave të nënshkruara. Nisur nga kjo propozimi ynë për shpërndarjen e tyre nëpër programet dhe nën-programet buxhetore dhe kategoritë ekonomike të shpenzimeve, është si vijon:

- Mallra dhe Shërbime në shumën prej 6,000.00 €;
- Shpenzimet komunale në shumën prej 3,374.57 €;
- Shpenzime kapitale në shumën prej 336,820.00 €.

Në kategorinë mallra dhe shërbime :

Administrata (16318), shuma prej 6,000.00 €.

- **Arsyetim:** Bartje e obligimeve të pashlyera si dhe shpenzimet e krijuara për zhvillimin e veprimtarisë.

Në kategorinë e shpenzimeve komunale :

Shërbimet e shëndetësisë primare (74050), shuma prej 3,374.57 €.

- **Arsyetim:** Bartje e obligimeve të pashlyera për shkak të rritjes së çmimit tek shpenzimet komunale.

Në kategorinë e shpenzimeve kapitale:

Administrata (16318), në projektet:

“Ndërtimi dhe renovimi i objektëve komunale të administratës”, kodi (52503), shuma prej 2,857.00 €;

Planifikimi urban dhe inspeksion (66395), në projektet:

“Asfaltimi i rrugëve lokale ne Cerovik-Qabiq”, kodi (48153), shuma prej 29,500.00 €;


“Asfaltimi i rrugëve lokale Gjurgjevik i Vogel- Klinave”, kodi (47221), shuma prej 10,000.00 €;

“Asfaltimi i rrugëve lokale ne Gremnik”, kodi (47171), shuma prej 15,000.00 €;

“Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokesore në Jashanicë-Jelloc-Resnik-Pogragjë”, kodi (49602), shuma prej 46,500.00 €;

“Asfaltimi i rrugëve Ujemir-Shtaricë-Siqevë”, kodi (50664), shuma prej 29,500.00 €;

“Asfaltimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokesore Volljakë-Sferkë-Qupeve”, kodi (50666), shuma prej 27,695.63 €;



“Ndërtimi me gurë i sheshit Mujë Krasniqi dhe rrugëve në qytet “, kodi (Projekt i Ri), shuma prej 68,922.72 €;
“Asfaltimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Krysheve e Vogel “, kodi (50667), shuma prej 25,000.00 €;
“Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në Qeskove “, kodi (51445), shuma prej 7,820.00 €.

Infrastruktura Rrugore (18018), në projektet:

“Sanimi i gropave të rrugëve me asfalt në Resnik, Leskoc etj.”, kodi (52516), shuma prej 39,510.00 €;
“Zgjerimi i rrjetit të ndriqimit publik në Përçevë, Shtaricë dhe Shtupel”, kodi (52513), shuma prej 34,514.65 €.

- **Arsyetim:** Në vitin 2022 dhe në vijim inflacioni global e ka rritur edhe koston e shpenzimeve. Për këtë arsye në vitin 2022 kemi kontrata që nuk janë realizuar sipas planifikimit buxhetor dhe kanë mbetur të kryhen në këtë vit si dhe disa projekte për shkak të inflacionit nuk kemi arritur t'i kontraktojmë, kemi obligime të pa përfunduara.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



KOMUNA E KLINËS MUNICIPALITY OF KLINA OPŠTINA KLINA		REPUBLIKA KOSOVA	
Prilidhet me dt. Kopjeron diton Prilidhet diton		11.07.2023	
Nj. Ur. Orgen. 3	Num. Kl. E	Shifra A. P.	Ant. Jst
01-052-22897/23			

PËR: Zyrën Kombëtare të Auditimit

NGA: Kryetari i Komunës së Klinës, z. Zenun Elezaj

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit për Komunën e Klinës në raportin e vitit 2022
për pasqyrat financiare vjetore

Nr.	Komponenta e auditimit	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për t'u ndërmarrë	Veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin e rekomandimeve	Statusi i rekomandimit (i zbatuar, pjesërisht i zbatuar ose i pazbatuar)	Sfidat e hasura në zbatimin e rekomandimit
1.	Çështja A1 - Mbivlerësimi i pasurisë jo financiare	Rregullorja MF-nr.02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare, në organizatat buxhetore, përcakton qartë rregullat dhe procedurat për menaxhimin e pasurive dhe stoqeve. Gjithashtu, Neni 6 i rregullës MF nr.01/2017 për Raportimin vjetor financiar nga OB përcakton që - Organizatat Buxhetore mbajnë regjistrat kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare. Në pesë (5) raste në vlerë 844,314€, investimet e bëra ndër vite për qytetarët, Komuna i kishte regjistruar në regjistrin e pasurisë edhe pse nuk janë në pronësi të Komunës, me ç 'rast pasuritë e komunës ishin mbivlerësuar. Rastet kanë të	Kryetari duhet të sigurojë se regjistri i pasurive është azhurnuar në mënyrë që i njëjti të përmbajë vetëm pasuritë në pronësi të komunës. Po ashtu, të sigurojë se vlera e pasurisë e prezantuar në PFV-të e komunës është e saktë.	Komuna menjëherë ka angazhuar komisionin për regjistrimin e pasurisë në koordinim me zyrtaren kompetente të regjistrimit të pasurisë, që ky rekomandim të zbatohet në afatin optimal në përputhshmëri me Rregulloren e MF nr.02/2013.	Është angazhuar stafi i Drejtorisë se Financave dhe komisioni.	Në procedurë të zbatimit në koordinim me MF.	

		<p>bëjnë me ndërtimin e shtëpive në fshatin Berkovë, 625,414€, participimi në fabrikën e Ujit-në Klinë 45,000€, ndërtimi i shtëpive në Rudicë 72,857€, fasadimi i objekteve në rr. “Dëshmorët e kombit”, 88,326€ dhe furnizim me serra për partnerët bujqësorë 12,717€. Shkaqet e kësaj qëndrojnë për faktin se, Komuna nuk ka rishikuar apo azhurnuar regjistrin e pasurisë e që rezulton me mosfunksionim të duhur të kontrolleve të brendshme lidhur me menaxhimin e pasurive. Regjistri i pasaktë, tregon menaxhim të dobët të pasurisë, si pasojë ka ndikuar në mbivlerësimin e pasurive si dhe në prezantimin jo të drejtë të pasurisë në pasqyra financiare.</p>					
2.	Çështja B1 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve	Sipas Rregullores Financiare, nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu ,me planin kontabël të Thesarit janë	Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike	Komuna me rastin e zhvillimit të procedurave të planifikimit buxhetor ,do të sigurojë që shpenzimet të	Është angazhuar Drejtoria e Financave	Në vitin aktual veçse ka filluar zbatimin e këtij rekomandimi.	

		<p>përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë. Komuna kishte bërë keq klasifikime të shpenzimeve, ku nga kategoria ekonomike, investime kapitale kishte paguar 34,158€, që për nga natyra i takojnë subvencioneve dhe tansfereve. Shpenzimet e paguara kanë të bëjnë me fuqizimin dhe punësimin e të rinjve, fuqizimin socio-ekonomik të Ballkanit perëndimor.</p> <p>Kjo ka ndodhur si pasojë e planifikimit të gabuar të shpenzimeve gjatë hartimit të buxhetit nga ana e Komunës dhe aprovimit të buxhetit nga Ministria e Financave.</p> <p>Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve ndikon në mbivlerësim/nënvlerësim të shpenzimeve në kategori të ndryshme si dhe prezantim jo të saktë të shpenzimeve në PFV.</p>	<p>adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël.</p>	<p>planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas Standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël.</p>			
3.	Çështja A2 - Zotimi i mjeteve financiare pas	<p>Sipas Rregullores Financiare, nr. 01/2013/MF - shpenzimi i parasë publike, neni 22, hapat për procedim të pagesave janë:</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se janë forcuar kontrollet e</p>	<p>Kryetari menjëherë pas rekomandimit në bordin e</p>	<p>Janë angazhuar nga Kryetari, Drejtoria e Financave,Ekono</p>	<p>Në proces të zbatimit.</p>	

<p>pranimi të faturës</p>	<p>kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, procedohet urdhërblerja, raporti i pranimi të mallit apo shërbimit, pastaj bëhet pranimi i faturës, tutje certifikohet/ekzekutohet pagesa në fjalë.</p> <p>Nga testimi i pagesave të punëve të kryera të projekteve kapitale, kemi hasur në tri (3) raste të pagesave, në vlerë 168,430€ që janë realizuar pa u zbatuar procedurat e duhura. Pra, janë pranuar mallra, shërbime dhe faturat para së të bëhet zotimi i mjeteve. Rastet kishin të bënin me:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Rinovimi i objekteve shkollore dhe fushave sportive, në vlerë 54,203€, zotimi i mjeteve dhe urdhërblerja ishin bërë pas pranimi të faturës (me 24.10.2022, ndërsa fatura e datës 07.10.2022 ishte protokolluar më datë 10.10.2022) • “Asfaltimi i rrugëve dhe infrastrukturës Klinë-Dresnik-Dollc ” në vlerë 61,514€, zotimi i mjeteve dhe urdhërblerja ishin bërë më datë 21.09.2022 , 	<p>brendshme në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procedimi i pagesave duhet të bëhet sipas kronologjisë së ngjarjeve dhe në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me rregulloren financiare për shpenzimin e parave publike.</p>	<p>drejtorëve ka nxjerrë konkluzë që faturave t’i paraprijnë zotimet dhe urdhërblerjet, i cili rekomandim veq ka filluar së zbatuari.</p>	<p>misë dhe Zhvillimit dhe drejtoritë tjera për veprim.</p>		
---------------------------	--	---	---	---	--	--

		<p>ndërsa fatura dhe raporti i menaxherit të kontratës ishin më datë 15.09.2022; dhe</p> <ul style="list-style-type: none"> • “Punë shtesë në projektin e asfaltimit të rrugëve Stupë – Zajm ” në vlerë 52,713€, zotimi i mjeteve ishte bërë më datë 19.10.2022, ndërsa fatura ishte e datës 22.09.2022. <p>Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme dhe hyrjeve në obligime pa siguruar mjete të mjaftueshme për projekte të caktuara.</p> <p>Zotimi i mjeteve pas pranimi të faturave, përveç se nuk është në pajtim me kërkesat e rregullës financiare, mund të ndikojë që të pranohen punë të kryera me shumë sesa ka mjete buxhetore, rrjedhimisht mund të krijohen vështirësi dhe vonesa për pagesë.</p>					
4.	Çështja A3 – Subvencionim i i fermerëve në kundërshtim me Thirrjet Publike	Sipas dy Thirrjeve Publike për subvencionimin e fermerëve me Serra (63,950€) dhe me Makina Mjelëse (7,290€) të shpallura më datën 23.02.2022, midis tjerash kërkohej që përfituesi të jetë banor i Komunës; të	Kryetari duhet të sigurojë se para se të bëhen shpalljet e thirrjeve publike për subvencionim	Drejtoria e Bujqësisë angazhohet që kjo çështje mos të përsëritet thirrjeve tjera.	Janë duke u ekzekutuar në përputhshmëri me thirrjen publike për rastet e njëjta.	Në proces të zbatimit.	

	<p>posedojë sipërfaqe të mjaftueshme të tokës për vendosjen e serrës; të ketë mundësi ujitjeje (posedojë bunar); të jetë i gatshëm që të marrë pjesë me 30 % të mjeteve financiare në koston e serrës; të merret me kultivimin e blegtorisë; të posedojë së paku 2 krerë lopë qumështore ose 20 krerë dele apo dhi të mbarësuara.</p> <p>Gjatë shqyrtimit të procesit të vlerësimit të dy thirrjeve publike, kemi vërejtur se Komisioni i Vlerësimit në formularin e poentimit ka përdorur kritere të cilat nuk kanë qenë të përfshira në asnjërën prej Thirrjeve Publike, si numri i anëtarëve familjarë, statusi i punësimit, gjendja ekonomike, përmes së cilave kritere të pa shpallura janë fituar pikë dhe janë vlerësuar përfituesit. Për më tepër, në lidhje me këtë çështje ne kemi testuar tetë (8) përfitues dhe Komisioni Vlerësues nuk kishte siguruar dëshmi fizike për asnjërin prej tyre, se kanë</p>	<p>të fermerëve, të bëhet një analizë e mirëfilltë e kritereve, në mënyrë që ato të shpallen dhe Komisionet e Vlerësimit të vlerësojnë aplikacionet me përpikëri të plotë kundrejt tyre.</p>				
--	---	--	--	--	--	--

		<p>përbushur kriteret e pashpallura si, numri i anëtarëve familjarë, statusi i punësimit, apo gjendjen ekonomike.</p> <p>Kjo ka ndodhur si pasojë e mosrespektimit të kriterëve të shpalljes publike nga ana e Komisionit Vlerësues.</p> <p>Subvencionimi i fermerëve, duke përdorur kriterë të cila nuk kanë qenë të shpallura në Thirrje, dëmton transparencën dhe shfaqë dyshime në tërë procesin, pasi që janë përdorur kriterë që nuk kanë qenë të shpallura në Thirrjet Publike, për të cilat aplikuesit nuk kanë qenë të njoftuar.</p>					
5.	<p>Çështja B2 - Vonesa në pagesën e faturave dhe shpenzimet shtesë të procedurave</p>	<p>Sipas nenit 39.1 të Ligjit Nr.03/L-048 për LMFPP, çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet të furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore, të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.</p> <p>Ndërsa, sipas nenit 40, fatura mund të ekzekutohet direkt nga</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha faturat dhe obligimet të paguhen brenda afateve kohore ligjore, me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me</p>	<p>Janë angazhuar menaxherët e kontratave që obligimet e planifikuara të krijuara sipas kontratave valide të kryhen sipas planifikimit dhe konform Ligjit aplikativ</p>	<p>Kanë filluar së zbatuari në përputhshmëri me legjislacionin aplikativ</p>	<p>Në proces të zbatimit</p>	

	<p>Thesari pas marrjes së urdhrorit të prerë nga gjykata/përmbartuesi. Nga testimi i pesë (5) mostrave në vlerë gjithsej 26,652€, kemi vërejtur se komuna me vonesë kishte kryer pagesat duke tejkaluar afatin ligjor për pagesë. Vonesat lëvizin nga 47 deri në 127 ditë.</p> <p>Më tutje nga rishikimi i pagesave të obligimeve kemi vërejtur se Thesari ka ekzekutuar pagesa direkt në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore për pagesën e kompensimeve të punëtorëve, si rezultat i kontratës kolektive, si dhe për dy OE për mos pagesë të borxhit në vlerë gjithsej prej 54,749€.</p> <p>Mospagesa e obligimeve me kohë, ka ndodhur për shkak hyrjes në obligime financiare pa pasur mjete buxhetore të planifikuara dhe mangësive në menaxhimin e obligimeve.</p> <p>Derisa mospagesa e obligimeve me kohë sa i përket pagave ka ndodhur për shkak të mungesës së mjeteve për shlyerjen e</p>	<p>kosto shtesë të përmbartimit.</p>	<p>në fuqi.</p>			
--	--	--------------------------------------	-----------------	--	--	--

		obligimeve të dala nga kontrata kolektive. Hyrja në obligime pa zotimin me kohë të mjeteve financiare, si dhe mospagesa e faturave dhe obligimeve me kohë e ekspozon Komunën ndaj padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/përmbartimore dhe të kamatave.					
6.	Çështja C1 – Mos aplikimi i plotë i Rregullores për Subvencionim të OJQ-ve	Rregullorja e MF - Nr – 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, përcakton se: Thirrja duhet të jetë e hapur për së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë pune (Neni 12.3); Secili nga anëtarët e Komisionit Vlerësues, para vlerësimit nënshkruan deklaratën mbi paanshmërinë dhe konfidencialitetin (Neni 16.2); Komisioni Vlerësues në mbledhjen e tij të parë miraton rregullat e punës (Neni 8.6); Të mos ketë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete (Neni 10.1.5). Thirrja Publike e datës 10.05.2022, për mbështetje	Kryetari duhet të shtojë kontrollet për të siguruar se zyrtarët të cilët janë përfshirë në proceset e dhënies së subvencioneve të jenë të informuar mirë në lidhje me kërkesat e Rregullores, në mënyrë që të mos përsëriten lëshimet e sipërpërmendura dhe të aplikohet me	Drejtoria e Kulturës dhe e Drejtoria e Bujqësisë, angazhohen që Rregullorja e MF nr. 04/2017 të aplikohet dhe zbatohet në tërësi.	Është angazhuar Drejtoria e Kulturës dhe Drejtoria e e Bujqësisë.	Ka filluar së zbatuari	

		<p>financiare për vitin 2022 për të gjitha Organizatat Joqeveritare në Komunën e Klinës, ishte mbajtur e hapur deri më 18.05.2022, apo shtatë ditë dhe jo 15 ditë, ndërsa anëtarët e Komisionit nuk kishin nënshkruar deklaratën mbi paanshmërinë dhe konfidencialitetin, nuk kishin miratuar rregullat e punës, dhe nuk kanë aplikuar formularin mbi burime tjera të financimit. Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontroleve të brendshme që ka rezultuar me mosrespektim të kërkesave të Rregullores së lartpërmendur. Mangësitë e listuara, dëmtojnë konkurrencën, paanshmërinë, transparencën, dhe paraqesin rrezik që fondet e dhëna të mos jepen për përfitueset meritor dhe për qëllimet e duhura.</p>	përpikëri të plotë.				
7.	Çështja C2 - Mangësi në bazën e të dhënave të tatimpaguesve në pronë	Ligji Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Neni 12, thekson se komuna ka përgjegjësi për regjistrim dhe menaxhim të të dhënave të tatimit në pronë në regjistrat e tatimit në prone, ashtu siç	Kryetari duhet të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të siguruar që baza e të dhënave të	Kryetari ka mobilizuar stafin e Drejtorisë së Financave që të sigurohen numrat	Kryetari ka mobilizuar stafin e Drejtorisë së Financave që të sigurohen numrat personal të tatim paguesve për	Në proces të zbatimit.	

	<p>përcaktohet në aktin nënligjor. Nga të dhënat e tatimit në pronë, është identifikuar se 528 tatimpagues të evidentuar në këtë bazë, nuk kanë të prezantuar numrat personal, të cilët në bazë të emrave, mbiemrave dhe emrit të prindit, mund të jenë potencialisht përfitues të disahershëm nga zbritja e lejuar ligjore. Kjo ka ndodhur si rrjedhojë e mosverifikimit të pronave në fjalë dhe mos azhurnimit të shënimeve në sistemin e tatimit në pronë i cili sistem po ashtu, për shkak të mangësive, lejon regjistrimin pa numër identifikues.</p> <p>Mungesa e të dhënave në data bazë për numrat personal të tatimpaguesve mund të ndikojë në përfitim të paligjshëm të disahershëm të tatimpaguesve, të zbritjes së lejuar për vendbanim parësor.</p>	<p>tatimit në pronë plotësohet me të gjithë numrat personal të tatimpaguesve, ashtu që të mundësohet verifikimi i të gjitha rasteve potenciale që mund të hasen me përfitim të disahershëm për vendbanim parësor.</p>	<p>personal e tatimpaguesve për përmbushjen e këtij kriteri.</p>	<p>përmbushjen e këtij kriteri.</p>		
--	--	---	--	-------------------------------------	--	--

8.	<p>Çështja B3 - Mos-nënshkrimi i planit të menaxhimit të kontratës nga palët kontraktuese</p>	<p>Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, pika 61.8 përcaktojnë se plani për menaxhimin e kontratës do të përgatitet para fillimit të zbatimit të kontratës dhe me pajtimin e palëve të kontratës. Kjo do të dokumentohet me nënshkrimet e të dyja palëve, përkatësisht, menaxherit të kontratës nga ana e Autoritetit Kontraktues dhe menaxherit të kontratës nga ana e Operatorit Ekonomik.</p> <p>Nga testimi i pesë (5) lëndëve për qëllime të pajtueshmërisë me procedura, kemi gjetur se kishte mangësi me planin e menaxhimit të kontratës. Në tre (3) raste, plani i menaxhimit të kontratës nuk është nënshkruar fare, ndërsa në një (1) rast plani është nënshkruar.</p> <p>Kjo ka ndodhur për shkak të neglizhencës së menaxherëve të kontratave, të cilët nuk kanë përfillur kërkesën e rregullave që t'i nënshkruajnë planin e menaxhimit të kontratave. Mosnënshkrimi i planeve përkatëse të menaxhimit të</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e emërimit të menaxherëve të kontratave, menjëherë pas nënshkrimit të kontratave, të nënshkruhet plani për menaxhimin e kontratave nga të dyja palët, në pajtim me kërkesat ligjore.</p>	<p>Zbatimi i vendimit lidhur me emërimin e menaxherëve të kontratave të cilët janë përgjegjës për secilën rregullësi të zbatimit të kontratave valide.</p>	<p>Menaxherët e kontratave menjëherë pas nënshkrimit të kontratave të hartojnë planin e menaxhimit në pajtim me kërkesat ligjore.</p>	<p>Në proces të zbatimit</p>	
----	---	---	---	--	---	------------------------------	--

		kontratave nga palët kontraktuese, shfaqë mungesë përgjegjësie nga zyrtarët komunalë dhe nuk konfirmon që plani i menaxhimit në të vërtetë është dakorduar nga të dyja palët, dhe kjo ndikon që të ndodhin vonesa në ekzekutimin e punëve.					
Çështja C3 - Vonesa në realizimin e kontratave	Neni 81 të LPP nr.05/L-068, si dhe Rregulla dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, pikat 61.6, 61.19 dhe 61.20 përcaktojnë që: Menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të sigurojnë se OE realizon kontratën në përputhje me afatet, termet dhe kushtet tjera të specifikuar në kontratë. Në katër (4) kontrata të investimeve kapitale punët nuk janë realizuar në pajtim me afatet/planet dinamike të përcaktuara në kontratat përkatëse. -Asfaltimi i rrugëve të infrastrukturës nëntokësore në Videjë-Paskuqan-Krushevë e M, projekti në vlerë 95,000€	Kryetari duhet të sigurojë se drejtoritë përkatëse, para nënshkrimit të kontratës të dakordohen në lidhje me vendosjen e planit dinamik të përfundimit të punëve, në mënyrë që të mos ketë vonesa.	Kryetari do të organizojë drejtoritë përkatëse që para nënshkrimit të kontratës të dakordohen lidhur me zbatimin e planit dinamik, në mënyrë që punët të kryhen në afatet e planifikuara.	Janë autorizuar menaxherët e kontratave dhe stafi i zyrës së prokurimit që këtë rekomandim ta zbatojmë në plotësi.	Në proces të zbatimit		

	<p>ishite paraparë të realizohet brenda 60 ditëve duke filluar nga data 08.09.2022, por nuk ka përfunduar ende;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në Kontratën për punë shtesë në projektin "Asfaltimi i rrugëve Stup –Zajm", në vlerë 79,157€, e nënshkruar më 29.04.2022 dhe ishte planifikuar të kryhej brenda 30 ditëve. Punët nuk janë realizuar në pajtim me afatet/planet dinamike të përcaktuara në kontratë, pasi nga Raporti i menaxherit të Kontratës kemi vërejtur se situacioni i parë për realizimin e punëve ishte dorëzuar më 06.10.2022; "Asfaltimi i rrugëve Leskoc – Ranoc – Zllakuqan", e nënshkruar më 07.07.2021 në vlerë 449,999€, e planifikuar për t'u kryer brenda 100 ditëve, duke filluar nga data 07.07.2021, punët nuk janë kryer ende; -Në projektin "Ndërtimi I rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në Volljakë-Sferkë-Qupeve" në kontratën e nënshkruar më 22.07.2022 në 					
--	--	--	--	--	--	--

		<p>vlerë 163,000, punët ishin planifikuar të kryheshin brenda 90 ditëve, ndërsa nuk janë kryer.</p> <p>Shkak i vonesave në realizimin e këtyre projekteve ishte moskoordinimi i zyrës së prokurimit dhe menaxherëve të kontratave me drejtoritë përkatëse, për përcaktimin e planeve adekuate dinamike.</p> <p>Dështimi për të realizuar kontratat përbrenda planeve dinamike të përcaktuara të kontratave, rrezikojnë realizimin e projekteve kapitale dhe objektivave komunale.</p>					
Çështja A4 - Regjistrimi i gabuar i pasurisë si Investime në vijim	<p>Neni 13, i pikës 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare ,përcakton se: të gjitha transaksionet e krijuara gjatë ndërtimit të pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore duhet të regjistrohen në regjistrat e organizatës financuese në kategorinë e investimeve në vijim dhe në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë që janë rishikuar regjistrat e pasurive, në mënyrë që të evidentohen të gjitha pasuritë që janë të regjistruara si Investime në vijim e që janë të finalizuar si projekte dhe të</p>	<p>Kryetari ka mobilizuar komisionet që deri në fund të vitit të evidentohen regjistratat e pasurive për të gjitha pasuritë që janë të regjistruara si investime në vijim dhe të bëhen</p>	<p>Janë organizuar drejtoritë kompetente që ky rekomandim deri në përfundim të vitit të plotësohet.</p>	<p>Në proces të zbatimit nga të gjithë faktorët relevant.</p>		

	<p>dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbyllë llogarinë e investimeve në vijim.</p> <p>Në regjistrin e pasurive mbi 1,000€ kemi identifikuar 75 artikuj të ndryshëm të pasurive, (si, rinovime, rregullim dhe asfaltim i rrugëve, rregullim i hapësirave gjelbëruese, automjete etj), të cilat ishin të regjistruara si pasuri Investime në vijim. Të njëjtat duhej të jenë të regjistruara si pasuri në përdorim dhe për to të kalkulohet zhvlerësimi konform shkallëve të caktuara me rregullore. Këto pasuri janë të blera gjatë viteve 2006 - 2019, vlera e tyre në regjistër të pasurive është 2,036,727€.</p> <p>Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së mjaftueshme të kontrolleve të brendshme ndaj menaxhimit të pasurive jo financiare.</p> <p>Mbajtja e artikujve të caktuar në regjistrin e pasurive si Investime në vijim, ndikon në mos zhvlerësimin e pasurive me kohë dhe mbivlerësimin</p>	<p>pranuara teknikisht. Po ashtu, të bëhen ndryshimet në regjistrin kontabël, në mënyrë që atyre pasurive t'u ndryshohet klasa dhe të aplikohet zhvlerësimi sipas normave të përcaktuara me rregullore.</p>	<p>ndryshimet në regjistrin kontabël që atyre pasurive t'u ndryshohet klasa dhe të aplikohet zhvlerësimi sipas normave të përcaktuara në Rregulloren në fuqi.</p>			
--	--	---	---	--	--	--

		potencial të vlerës së pasurive.					
Çështja A5 - Mangësi në menaxhimin e dosjeve të llogarive të arkëtueshme	<p>Sipas nenit 6 i Rregullores Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, parasheh se: "Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare".</p> <p>Nga testimi i mostrave të LL/A , për gjashtë raste lidhur me shfrytëzuesit e pronës publike me vlerë 5,982€, Komuna nuk ka arritur të na sigurojë dëshmi si kontratat e lidhura me shfrytëzuesit e pronës, fatura apo kartela analitike financiare. Prandaj nuk mund të konfirmohet se shuma e prezantuar dhe shpalosur e këtyre llogarive është e saktë, për më tepër se këto llogari janë të bartura ndër vite.</p> <p>Sipas konfirmimeve të zyrtarëve nga departamenti përkatës, dëshmi të tilla nuk mund të gjenden as në arkivë dhe as në financa.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët të ndërmarrin veprime për plotësimin e lëndëve të borxhlinjve, në mënyrë që të ketë dëshmi që ofrojnë siguri se shumat e paraqitura të LLA janë të sakta.</p>	<p>Kryetari ka obliguar Drejtorinë e Financave që menjëherë, në mënyrë sistematike, t'i ndërmarrin të gjithë hapat ligjor për menaxhimin e llogarive të arkëtueshme dhe ekzekutimin e tyre, si dhe ka formuar komision për evidentimin e të gjitha llogarive të arkëtueshme.</p>	<p>Organizimi dhe evidentimi i llogarive të arkëtueshme sipas kontratave.</p>	<p>Në proces të zbatimit.</p>		

		Mos kompletimi i dosjeve/kartelave të borxhlinjve nuk japin siguri se borxhi është i saktë dhe i plotë.					
Çështja C4 - Rritja e vazhdueshme e llogarive të arkëtueshme	<p>Neni 6 i Rregullores Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, parasheh se: “Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”.</p> <p>Neni 26 Ligji nr.06/L-005 Për tatimin në pronën e paluajtshme, përcakton se Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbareuese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e 10€. Po ashtu, në Aktvendimet për ushtrimin e veprimtarisë afariste apo profesionale, përcaktohet se pagesa e ngarkesës së caktuar bëhet në dy këste: Kësti i parë bëhet deri më 15.06 të vitit aktual, ndërsa</p>	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se zyrtarët në departamentet përkatëse do të intensifikojnë veprimet dhe ndërmarrin të gjitha masat për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme dhe zvogëlimin e trendit të tyre rritës ndër vite.	Kryetari ka obliguar Drejtorinë e Financave që menjëherë, në mënyrë sistematike, t'i ndërmarrin të gjithë hapat ligjor për menaxhimin e llogarive të arkëtueshme dhe ekzekutimin e tyre në kontiunitet të vazhdueshëm.	Obligohet Drejtoria e Financave që kjo çështje të zbatohet nga zyrtarët kompetentë, duke marrë masa ligjore për inkasim të mjeteve financiare, si nga tatimi në pronë dhe të hyrat tjera.	Në proces të zbatimit.		

	<p>Kësti i dytë bëhet deri më 15.12 të vitit aktual.</p> <p>Edhe përkundër faktit se gjatë vitit 2022 komuna kishte ndërmarrë veprime për mbledhjen e borxheve duke dërguar letër përkujtime të borxhlinjtë, Llogaritë e arkëtueshme në total krahasuar me vitin paraprak 2,893,036€, janë rritur në 3,199,211€, me diferencë 306,176€ apo 10%.</p> <p>Rritja më e madhe ka ndodhur te tatimi në pronë si dhe te licencat për biznes.</p> <p>Komuna nuk ka ndërmarrë masa shtesë (përveç letër kujtimit) të borxhlinjtë, si ajo e veprimeve ligjore përmes përmbaresit në mënyrë që të detyrojë taksa/tatimpaguesit në pagesën e obligimeve.</p> <p>Mungesa e veprimeve të mjaftueshme për të mbledhur të gjitha të hyrat me kohë, paraqet rrezik për dëmtimin e buxhetit komunal si dhe rritë rrezikun e vjetërsimit të llogarive të arkëtueshme.</p>					
--	--	--	--	--	--	--

Kryetari i Komunës së Klinës: Zenun Elezaj






REPUBIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna e Klinës

Zyra e kryetarit

Klinë, 26. 06. 2023

PROCESVERBAL

Nga takimi i parë i kryetarit të Komunës së Klinës, z. Zenun Elezaj me qytetarët e Komunës së Klinës, mbajtur me datë 26. 06. 2023 në sallën e Kuvendit të Komunës, duke filluar nga ora 10:00

Kryetari z. Elezaj falënderoj qytetarët për pjesëmarrës në këtë takim të parë për vitin 2023 dhe i informoi se do të ju jap një raport për punën e bërë të ekzekutivit.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Përshëndetje të gjithëve. Mirë se keni ardhur. Fillimisht buxheti për vitin 2023 ka qenë në vlerën 13 milion e 51 mijë e 595 euro i cili ka filluar në kohë që të implementohet. Në momentin që është hapur thesari edhe ne kemi filluar realizimin e projekteve përmes [procedurave të prokurimit. Të gjitha procedurat kanë nisur me kohë dhe mendoj që jemi në një vit të suksesshëm dhe realizimi i buxhetit ka filluar të shpenzohet më mirë se sa në vitin e kaluar. Deri me tani kemi arritur të shpenzojmë nga kategoria paga dhe mëditje – 2 milion e 984 mijë euro. Nga Mallra dhe shërbime – 770 mijë, 148 mijë e 510 euro – shpenzime komunale, subvencione- 161 mijë euro dhe projekte kapitale- 1 milion e 61 mijë euro. Totali i shpenzimit të buxhetit deri sot është 5 milion e 125 mijë e 692 euro ose 33.2 % .

Tek investimet kapitale jemi pak më ultë por kjo vlerë është e natyrshme sepse janë procedurat e prokurimit që nisin në muajin shkurt , pastaj lidhjet e kontratave etj. që e shtyjnë procedurën. Krahasuar me vitet paraprake është realizim më i mirë. Këtë vit kemi arritur që të kemi edhe grandin e performancës diku 770 mijë euro. Projektet e mëdha janë në procedura dhe janë ndarë mjete që të realizohen. Projekti për furnizim me ujë për të cilin projekt shpresoj që ta kemi kontratën në muajin Gusht. Do të merret uji direkt nga Drini diku 100 L /s aq sa është edhe kapaciteti i fabrikës. Do të ndërrohen filtrat e fabrikës dhe shpresoj që në marsin e vitit të ardhshëm do të kemi edhe 100 l/s ujë të pijshëm për qytetarët e Klinës. Kemi filluar me mbikëqyrjen e kontratave përmes procedurave të prokurimit dhe e- prokurimit që është një procedurë më e avancuar. Përmes këtij procesi automatikisht kompanisë që nuk e realizon

planin dinamik i shkon njoftimi dhe kompania futet në listën e zezë. Nëse keni dikush me pyet , të sugjeroj, urdhëroni merreni fjalën.

z. Ton Marku, Deiq: Përshëndetje për të gjithë. Dëshiroj të njoftohem me disa punë që janë në projekt. Mendoj që mirë ka punuar kryetari dhe e përgëzoj për shpërndarjen e buxhetit në mënyrë të barabartë pa bërë fare dallime. E shoh gjithashtu se punët nuk po ndalen në asnjë minutë. Kam një kërkesë për rrugën Klinë-Deiq, janë disa pengesa në rrugë. Vetëm tek shtëpia e N.B. janë 5 pengesa në rrugë shto edhe një “polic të vdekur”. Mendoj që do të ishte mirë që të hiqen dhe shpejtësia të kufizohet me shenja komunikacioni. Po ashtu një kërkesë tjetër imja është që të kenë kriter kur të prehet asfalti për arsye sepse po prehet dhe nuk po rregullohet me. Kanë qenë disa projekte që i keni përmendur tek “Ura e Haxhisë” a janë në ndonjë fazë të realizimit? Një kërkesë tjetër e fshatit është të dinë deri ku kanë shkuar procedurat e ofrimit të ndihmës për familjet e prekura nga vërshimet.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Faleminderit Ton. Për pengesat në rrugë, drejtori është këtu dhe do ta ketë parasysh shqetësimin tuaj. Për prerjen e asfaltit kam kërkuar që të merret pëlqim paraprakisht nga drejtorja e linjës. Të epët një afat 7 ditor që pas prerjes së asfaltit të kthehet në gjendje të mëparshme. Kompensimi i dëmeve të vërshimeve , ne kemi hartuar raport përmes komisionit dhe është aprovuar nga Kuvendi. Ky raport ju ka dërguar qeverisë dhe po presim nga ajo që të ndajë fonde. Bashkndejm dhimbje me rastin që ndodhi në Pejë por nganjëherë institucionet komunale e kanë të pa mundur që të bëjnë më shumë. Për fshatin Zajm-Deiq, planifikohet që të ndërtohet një urë që ta shkarkoj ujin që grumbullohet të “Ura e Haxhisë”. Këtë vit ne si nivel komunal e kemi një fond të vogël, po presim përgjigje nga niveli qendror, fundin e këtij muaji ose javën e parë të Korrikut ne do të nisim me buxhetin që kemi. Lumenj ne mund të i mirëmbajmë por ata kanë devijuar shtratin me kalimin e viteve .

Shefqet Kamberaj, Jashanicë: Përshëndetje. Dëshiroj të di se a do të rregullohet kanalizimi i ujërave të zeza në Jashanicë. Vitin e kaluar është shtri një kanalizim por në atë kanalizim është kyç vetëm një shtëpi, pjesa dërmuese e fshatit nuk ka pasur mundësi. Kemi pasur probleme edhe me bashkëfshatarët sepse ujërat e zeza po ju rrjedhin nëpër pronat e tyre. Na është premtuar vazhdimisht se brenda një muaji, dy muaji do të kryhen por akoma ashtu kemi mbetur. Kemi probleme edhe me mungesën e ujit të pijshëm. Diku po ndërtohet hapësira të gjelbra e te ne nuk ka as kanalizim.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: E diji rastin në Jashanicë. Ne vitin e kaluar e kemi ofruar kanalizimin deri në hyrje të lagjes. E kemi futur në projekt por ai projekt ka pasur telashe. Gabimisht është regjistruar vetëm rruga “Afrim Haliti” ndërsa atë buxhet ne e kemi pasur për të gjitha projektet në Jashanicë. Por ketë gjë tani më e kemi rregulluar , projekti i kanalizimit është tenderuar për Jashanicë dhe tanimë pritet nënshkrimi i kontratës . Po ashtu edhe për shtrimin e të gjitha rrugicave me asfalt përfshirë edhe kanalizimi nëpër ato rrugica në Jashanicë.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj

Kryetari:

Prof. Dr. Zenun Elezaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim

**RAPORT I MENAXHIMIT FINANCIAR I KOMUNËS SË KLINËS PËR
PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2023**

RAPORTI GJASHTËMUJOR ËSHTË PËRGATITUR BAZUAR NË LIGJIN NR. 03/L-048, MBI
MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË

1. Hyrje	3
1.1. Granti Qeveritar.....	3
1.2. Granti i të hyrave vetanake	3
1.3. Të hyrat vetanake të bartura.....	3
1.4. Performanca e shpenzimeve.....	4
2. Të hyrat buxhetore të komunës së Klinës për vitin 2023 duke i përfshirë edhe të hyrat nga donatorët sipas burimit të financimit	5
3. Të hyrat vetanake (sipas llojeve) të realizuara për periudhën janar-qershor 2023 dhe krahasimi me periudhën e njëjtë të vitit paraprak	6
3.1. Realizimi i të hyrave për periudhën janar-qershor 2023 sipas muajve	7
4. Shpenzimet buxhetore për periudhën janar-qershor 2023 dhe krahasimi me vitin paraprak.....	8
4.1. Shpenzimet e buxhetit në periudhën janar-qershor 2023 sipas kategorive ekonomike.....	9
5. Shpenzimet buxhetore për periudhën janar-qershor 2023 - raportit të shpenzimeve analitike sipas kodeve buxhetore në SIMFK	12

1. Hyrje

Raporti për periudhën janar-qershor 2023 është përgatitur në pajtim me dispozitat e nenit 45, paragrafët 45.2, 45.4 dhe 46.1 të Ligjit nr. 03/L – 048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Raporti i përgatitur paraqet buxhetin në SIMFK, shpenzimet dhe arkëtimin e të hyrave .

Raport financiar për buxhetin, të hyrat dhe shpenzimet për periudhën janar-qershor 2023 është punuar për të analizuar realizimin e buxhetit në periudhën janar-qershor 2023 do të japim një pasqyrë të buxhetit, të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, do të analizojmë disa trende të këtyre kategorive buxhetore si dhe do të bëjmë disa krahasime me parametrat buxhetor për këtë periudhë dhe disa krahasime me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Buxheti sipas SIMFK për vitin 2023 duke përfshirë edhe të hyrat nga grantet e brendshme dhe te jashtme është **14,508,039.98 €**, buxheti për këtë periudhë është më i lart për 15.52% se buxheti i vitit 2022.

Gjithsej pagesat kanë shënuar rritje prej 31.42% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, ku kontributin më të madh në këtë rritje gjatë kësaj periudhe e ka dhënë kategoria e shpenzimeve kapitale, shpenzimeve komunale, mallrave dhe shërbimeve.

1.1 Granti Qeveritar

Granti Qeveritar është burimi kryesor i financimit të buxhetit komunal, ku pjesëmarrja është 80.49% në vitin 2023 (shuma 11,677,821.00 €). Në raport me vitin paraprak buxheti nga GQ është 13.74% më i lart.

1.2 Granti I të hyrave vetanake

Buxheti nga të hyrat vetanake të komunës për vitin 2023 është shuma prej 1,373,774.00 € (9.47 e shumës së përgjithshme vjetore) krahasuar me vitin paraprak kanë shënuar rritje prej 28.89 % .

Grumbullimi i të hyrave buxhetore gjatë këtij gjashtëmujori kanë arritur shumën prej 815,238.34 €. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak të hyrat tatimore dhe jotatimore kanë shënuar një rritje prej 10.62% që korrespondon me 78,248.53 € më shumë në krahasuar me gjashtëmujorin e vitit paraprak.

1.3 Të hyrat vetanake të bartura

Buxheti nga THV të bartura të vitit 2022 gjatë periudhës janar-qershor 2023 është shuma prej 976,793.04 € .

Përveç Grantit Qeveritar dhe THV si burime të rregullta të financimit, si burim të financimit në këtë periudhë kemi edhe donacionet e brendshme të bartura, participimet e qytetarëve dhe grante tjera siq janë :

- ❖ **Granti i donatorëve të brendshëm - Participimi i qytetarëve** në shumën prej 31,332.12 €, në raport me vitin paraprak buxheti nga ky grant është **18.49 %** (shuma 26,443.62€) më i lartë se në vitin paraprak. Ndikim në rritjen e këtij granti ka qenë bartja e donacioneve të brendshme në këtë vit shuma 20,082.12 € dhe 11,250.00 € janë të hyra nga donatorët e brendshëm të dedikuara për ndihmë ndaj të prekurve nga vërshimet.
- ❖ **Grante tjera të jashtme - Donacion i jashtëm** në shumën prej 18,341.33 €, mjete këto të grumbulluara për ndihmë ndaj të prekurve nga vërshimet.
- ❖ **Granti i performancës** në total është shuma prej 776,403.11 €, në periudhën janar-qershor 2023 i kemi të alokuara vetëm mjetet **nga DEMOS** në shumën prej **426,739.48 €**, ndërsa mjetet tjera në shumën prej 349,663.63 € janë zotuar nga MAPL.

1.4 Performanca e shpenzimeve

Shpenzimet buxhetore në periudhën janar-qershor 2023 në shumën prej 5,940,563.13€ krahasuar me shpenzimet për periudhën e njëjtë të vitit 2022 në shumën prej 4,520,502.62 € janë më të larta për 31.41 % . Ndikim në rritjen e shpenzimeve ka pasur kategoria e shpenzimeve kapitale, shpenzimeve komunale, mallrave dhe shërbimeve.

Buxheti i shpenzuar në periudhën janar-qershor 2023 në shumën prej 5,940,563.13€ është 40.95 % e buxhetit në SIMFK krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për vitin 2023. Nga Granti qeveritar janë shpenzuar 5,622,491.61 € (48.15 % në raport me buxhetin nga Granti), nga të hyrat vetanake 2023 janë shpenzuar 93,756.66 € (6.82% në raport me buxhetin nga Granti), nga të hyrat e bartura 222,228.19 € (22.75% në raport me buxhetin nga Granti), nga donacioni jashtëm – Save The Children 2086.67€ (64.42% në raport me buxhetin nga donacioni).

Ndërsa nga totali i buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë në shumën prej 5,940,563.13€ nga granti qeveritar janë shpenzuar 94.65% , nga të hyrat vetanake të vitit 2023 janë shpenzuar 1.58%, nga të hyrat e bartura 3.74%, dhe nga Save the Children 0.04 % . Krahasuar me vitin 2022 , shpenzimet për këtë periudhë janë më të larta për 31.41 % .


- ❖ **Shpenzimet për paga dhe medijtje** gjatë këtij gjashtëmujori, shënuan shpenzimin prej 3,624,911.34 €, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 53.65 % krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori. Shpenzimet e pagave gjatë periudhës raportuese, paraqesin një rritje prej 14.26%, apo rreth 452,464.48 € më shumë krahasuar me shpenzimet e pagave në periudhën e njëjtë të vitit 2022. Ndikim në këtë rritje të shpenzimit ka pasur hyrja në fuqi Ligji i ri i pagave.
- ❖ **Shpenzimet në mallra dhe shërbime** kanë shënuar një rritje prej 36% krahasuar me vitin 2022. Gjatë kësaj periudhe shuma e këtyre shpenzimeve ka arritur në 805,826.29 €, kjo shumë korrespondon me 45.43% të buxhetit për këtë kategori. Shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve gjatë periudhës raportuese, paraqesin një rritje prej 36%, apo rreth 213,312.04 € më shumë krahasuar me shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve në periudhën e njëjtë të vitit 2022.
- ❖ **Shpenzimet në komunali**, kanë shënuar rritje prej 67.98% krahasuar me vitin 2022. Gjatë kësaj periudhe shuma e këtyre shpenzimeve ka arritur 149,292.72 €, kjo shumë korrespondon me 63.48% të buxhetit për këtë kategori. Shpenzimet e komunaleve gjatë periudhës raportuese paraqesin një rritje prej 67.98 % , apo rreth 60,419.07 € më shumë krahasuar me shpenzimet e komunaleve në periudhën e njëjtë të vitit 2022. Ndikim në këtë rritje të shpenzimeve ka qenë borgji i bartur i kësaj kategorie nga viti 2022 dhe rregullimi i infrastrukturës-zgjerimi i ndriqimit publik.
- ❖ **Shpenzimet në subvencione dhe transfere**, shënuan shumën prej 172,221.35.00 € gjatë këtij gjashtëmujori, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 40.58% krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori. Te subvencionet dhe transferet, gjatë periudhës raportuese paraqitet një rritje prej 13.15%, apo rreth 20,014.45€ më shumë krahasuar me subvencionet dhe transferet në periudhën e njëjtë të vitit 2022.
- ❖ **Shpenzimet kapitale**. Shpenzimet kapitale arritën shumën prej 1,188,311.43 €, që është 22.35% krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori. Shpenzimet kapitale gjatë periudhës raportuese paraqesin një rritje prej 130.98 % , apo rreth 673,850.47 € më shumë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2022.

2. Të hyrat buxhetore të komunës së Klinës për vitin 2023 duke përfshirë edhe të hyrat nga donatorët sipas burimit të financimit

Burimi i mjeteve	Buxheti sipas SIMFK për vitin 2023	% në total	Buxheti sipas SIMFK për vitin 2022	Ndryshimi 2023/2022 në %
Granti qeveritar	11,677,821.00	80.49	10,267,467.00	13.74

Të hyrat vetanake 2023	1,373,774.00	9.47	1,065,865.00	28.89
Të hyrat e bartura	976,793.04	6.73	1,196,666.06	(18.37)
31_Granti I donatorëve të brendshëm	31,332.12	0.22	26,443.62	18.49
32_Granti I donatorëve të jashtme	18,341.33	0.13	-	
46_ Save The Children	3,239.01	0.02	2,718.84	19.13
61_ Granti I jashtëm (Performancës)	426,739.48	2.94		
TOTALI	14,508,039.98	100.00	12,559,160.52	15.52

Tabela 1. Buxheti janar-qershor 2023 sipas burimit të financimit



Grafiku 1. Buxheti në SIMFK sipas burimit


2. Të hyrat vetanake (sipas llojeve) të realizuara për periudhën janar-qershor 2023 dhe krahasimi me periudhën e njëjtë të vitit paraprak

Nr.	Kodi ekonomik	LLOJET E TRANSAKSIONEVE	Gjashtëmujori	%	Gjashtëmujori	%	Krahasimi	Ndryshimi
			2022	Ne total	2023	Ne total		
1	40110	TATIMI NË PRONË	224,530.77	30.47	339,456.30	41.64	51.18	114,925.53
2	50001	TAKSË REGJISTRIMI I AUTOMJETEVE	35,070.00	4.76	38,325.00	4.70	9.28	3,255.00
3	50009	TAKSË PËR LEJE NDËRTIMI	191,472.77	25.98	148,150.18	18.17	(22.63)	(43,322.59)
4	50013	ÇERTIFIKATAT E LINDJES	590.00	0.08	331.00	0.04	(43.90)	(259.00)
5	50014	ÇERTIFIKATAT E KURORIZIMIT	1.00	0.00	90.00	0.01	8,900.00	89.00
	50015	ÇERTIFIKATAT E VDEKJES	402.00		407.00			5.00

6				0.05		0.05	1.24	
7	50016	ÇERTIFIKATA TJERA	17,244.20	2.34	19,697.00	2.42	14.22	2,452.80
8	50017	TAKSË VERIF. DOK.TË NDRYSHME	5,159.00	0.70	2,068.00	0.25	(59.91)	(3,091.00)
9	50019	TAKSA ADMINISTRATIVE	1,303.70	0.18	1,281.71	0.16	(1.69)	(21.99)
10	50024	ÇERTIFIKATAT MJEKSORE		-	180.00	0.02		180.00
11	50026	TAKSË PË LEGALIZIM		-	3,521.15	0.43		3,521.15
12	50029	TAKSË PËR USHTRIM TE VEPRIMTARISË		-	38,650.60	4.74		38,650.60
13	50032	TAKSË PËR FLETË POSEDUESE		-	9,136.00	1.12		9,136.00
14	50103	LARGIMI DHE DEPONIMI I AUTOMJE	1,039.50	0.14	345.00	0.04	(66.81)	(694.50)
15	50104	GJOBAT NGA INSPEKTORIATI	8,775.00	1.19	9,637.23	1.18	9.83	862.23
16	50205	LIC.PRANIM TEKNIK TE LOKALIT	4,042.05	0.55	3,269.50	0.40	(19.11)	(772.55)
17	50217	LIC.PËR DYQANE TË MËDHA	45,262.25					
18	50401	SHITJA E SHERBIMEVE	-					
19	50403	TE HYRAT NGA SHITJA E MALLRAVE	-					
20	50405	SHFRYTEZIMI I PRONES PUBLIKE	6,797.23	0.92	5,335.05	0.65	(21.51)	(1,462.18)
21	50406	PRONA PUB.PER TREG.TE HAPUR	2,000.00	0.27	1,030.00	0.13	(48.50)	(970.00)
22	50407	QIRAJA VENDOSJA OBJEKT TREGTAR	4,732.50	0.64	2,641.00	0.32	(44.19)	(2,091.50)
23	50408	QIRAJA NGA OBJEKTET PUBLIKE	13,009.00	1.77	13,922.62	1.71	7.02	913.62
24	50409	PARTICIPIM - SHENDETSIA	22,459.00	3.05	16,746.00	2.05	(25.44)	(5,713.00)
25	50409	PARTICIPIM - QERDHJA	13,931.74	1.89	15,838.00	1.94	13.68	1,906.26
26	50409	PARTICIPIM - ARSIMI I MESEM	14,453.10	1.96	21,290.00	2.61	47.30	6,836.90
27	50409	PARTICIPIM NGA GJEODEZIA		-	102.00	0.01		102.00
28	50504	TAX PER MATJEN TOKES NE TEREN	36,189.00	4.91	27,735.00	3.40	(23.36)	(8,454.00)
29		GJOBAT NGA TRAFIKU	84,476.00	11.46	92,788.00	11.38	9.84	8,312.00
30		GJOBAT NGA GJYKATA	4,050.00	0.55	3,265.00	0.40	(19.38)	(785.00)
		GJITHESEJT:	736,989.81	100.00	815,238.34	100.00	10.62	78,248.53

Tab.2. Të hyrat vetanake (sipas llojeve) të realizuara për periudhën janar-qershor 2023 dhe krahasimi me periudhën e njëjtë të vitit paraprak

KRAHASIMI I TË HYRAVE NDËR VITE



Grafiku 2. Të hyrat vetanake sipas viteve


3.1.

Realizimi I të hyrave vetanake për periudhën janar-qershor 2023 sipas muajve

Nr .	KODI EKONOMIK	LLOJET E TRANSAKSIONEVE	Të hyrat janar 2023	Të hyrat shkurt 2023	Të hyrat mars 2023	Të hyrat prill 2023	Të hyrat maj 2023	Të hyrat qershor 2023	Totali I të hyrave janar-qershor 2023
1	40110	Tatimi ne prone	36,517.94	23,727.84	40,184.56	66,061.77	143,432.54	29,531.65	339,456.30
2	50001	Taksa rrugore	6,690.00	5,780.00	6,975.00	4,705.00	6,555.00	7,620.00	38,325.00
3	50009	Urbanizem	1,882.82	74,809.17	36,440.56	15,117.49	4,619.81	15,280.33	148,150.18
4	50013	Çertifikatat e lindjes	32.00	9.00	126.00	20.00	53.00	91.00	331.00
5	50014	Çert. E kurorozimit	-	-	-	40.00	-	50.00	90.00
6	50015	Çertifikatat e vdekjes	-	55.00	113.00	-	116.00	123.00	407.00
7	50016	Çertifikatat tjera	3,274.00	2,866.00	3,231.00	2,738.00	4,205.00	3,383.00	19,697.00
8	50017	Te hyrat tjera	372.00	-	464.00	340.00	300.00	592.00	2,068.00
9	50019	Taksa administrative	362.60	312.90	147.10	107.41	257.80	93.90	1,281.71
	50024	Çertifikatat mjeksore				-	72.00	108.00	180.00
10	50026	Takë per legalizim	-	1,447.92	1,474.16	346.07	253.00	-	3,521.15
11	50032	Taksë per flet posed.	1,389.00	1,217.00	2,476.00	1,139.00	1,715.00	1,200.00	9,136.00
12	50103	Marimanga	-	345.00	-	-	-	-	345.00
13	50104	Denimet mandatore	5,500.00	150.00	2,442.23	230.00	115.00	1,200.00	9,637.23

14	50205	Komisioni inspektues	233.00	465.00	928.50	80.00	1,345.00	218.00	3,269.50
15	50029	Taksa nga licensa	4,040.00	4,660.00	9,740.00	5,760.00	9,817.50	4,633.10	38,650.60
16	50401	Shitja e sherbimeve	-	-	-	-	-	-	-
17	50403	Shitja e pasurise	-	-	-	-	-	-	-
18	50405	Shfryt.pron.publike	1,383.03	150.00	1,260.00	50.00	800.00	1,692.02	5,335.05
19	50406	Qer. per treg te hapur	-	-	-	-	1,030.00	-	1,030.00
20	50407	Qeraja e lokaleve	290.00	100.00	291.00	500.00	869.00	591.00	2,641.00
21	50408	Qeraja per banim	615.00	2,683.10	4,819.96	2,335.00	2,145.68	1,323.88	13,922.62
22	50409	Participim - shendetsi	3,536.50	3,101.50	3,141.50	2,053.00	2,129.50	2,784.00	16,746.00
23	50409	Participim - qerdhja	2,553.00	2,603.00	2,604.00	2,873.00	2,703.00	2,502.00	15,838.00
24	50409	Participim - shp. F.A.	50.00	2,410.00	15,820.00	1,460.00	1,000.00	550.00	21,290.00
25	50409	Participim nga gjeod.	9.00	18.00	12.00	39.00	16.00	8.00	102.00
28	50504	Kadaster & gjeodezi	3,010.00	3,786.00	7,092.00	4,575.00	5,368.00	3,904.00	27,735.00
29		Gjobat nga trafiku	28,500.00	27,465.00	36,823.00	-	-	-	92,788.00
30		Gjobat nga gjykata	1,365.00	430.00	1,470.00	-	-	-	3,265.00
TOTALI			101,604.89	158,591.43	178,075.57	110,569.74	188,917.83	77,478.88	815,238.34

Tab.3. Të hyeat vetanake (sipas llojeve) të realizuara për periudhën janar-qershor 2023 sipas muajve




Grafiku 3. Të hyrat sipas muajve

4. Shpenzimet buxhetor për periudhën janar-qershor 2023 dhe krahasimi me vitin paraprak

Burimi i mjeteve	Buxheti sipas SIMFK për vitin 2023	% në total	Buxheti i shpenzuar janar-qershor 2023	Progresi ndaj buxhetit në %	% në total e shpenzi meve janar-qershor 2023	Buxheti i shpenzuar janar-qershor 2022	Krahasimi i shpenz. 2023 me 2022 në %
Granti qeveritar	11,677,821.00	80.49	5,622,491.61	48.15	94.65	4,317,744.00	30.22
Të hyrat vetanake 2023	1,373,774.00	9.47	93,756.66	6.82	1.58	141,163.45	(33.58)
Të hyrat e bartura	976,793.04	6.73	222,228.19	22.75	3.74	37,514.83	492.37
31_Granti I donatorëve të brendshëm	31,332.12	0.22	-	-	-	21,361.50	(100.00)
32_Granti I donatorëve të jashtme	18,341.33	0.13	-	-	-	-	
46_ Save The Children	3,239.01	0.02	2,086.67	64.42	0.04	2,718.84	(23.25)
61_ Granti I jashtëm (Performancës)	426,739.48	2.94	-	-	-		
TOTALI	14,508,039.98	100.00	5,940,563.13	40.95	100.00	4,520,502.62	31.41

Tab.4. Shpenzimet buxhetore janar-qershor 2023 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar




Grafiku 4. Shpenzimet buxhetore janar-qershor 2023 krahasuar me periudhën enjëjtë të vitit të kaluar

4.1. Shpenzimet e buxhetit në periudhën janar-qershor 2023 sipas kategorive ekonomike

Përshkrimi	Buxheti në SIMFK 2023	Shpenzimet janar-qershor 2023	Progresi ndaj buxhetit në %	% në total e shpenz. janar-qershor 2023	Shpenzimet janar-qershor 2022	Krahasimi 2023 me 2022 në %
Paga dhe mëditje	6,756,927	3,624,911.34	53.65	61.02	3,172,446.86	14.26
Mallra dhe shërbime	1,773,710	805,826.29	45.44	13.57	592,514.25	36
Shërbime komunale	235,184	149,292.72	63.48	2.51	88,873.65	67.98
Subvencione dhe transf.	424,435	172,221.35	40.58	2.90	152,206.90	13.15
Kapitalet	5,317,785	1,188,311.43	22.35	20.00	514,460.96	130.98
TOTALI	14,508,039.98	5,940,563.13	40.95	100	4,520,502.62	31.41

Tab. 4.1. Shpenzimet buxhetore janar-qershor 2023 sipas kategorive ekonomike



Grafiku. 4.1. Shpenzimet buxhetore janar-qershor 2023 sipas kategorive ekonomike

Nga buxheti i shpenzuar në periudhën janar – qershor 2023 në shumën prej 5,940,563.13€:

- Për paga dhe medijtje janë shpenzuar 3,624,911.34 € (53.65 % në raport me buxhetin e alokuar për paga)
- Për mallra e shërbime janë shpenzuar 805,826.29 € (45.43 % në raport me buxhetin e alokuar për mallra e shërbime)
- Për shërbime komunale janë shpenzuar 149,292.72€ (63.48% në raport me buxhetin e alokuar për shërbime komunale)
- Për subvencione janë shpenzuar 172,221.35 € (40.58 % në raport me buxhetin e alokuar për subvencione) dhe
- Për shpenzime kapitale 1,188,311.43 € (22.35% në raport me buxhetin e alokuar për shpenzime kapitale).

Ndërsa nga totali i buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë në shumën prej 5,940,563.13€, për paga e medijtje janë 61.02 % e shpenzimeve, për mallra dhe shërbime 13.56 % e shpenzimeve, për shërbime komunale 2.51 % e shpenzimeve, për subvencione 2.90 % e shpenzimeve dhe për kapitale 20 % e shpenzimeve.

Shpenzimet në periudhën janar-qershor 2023 në shumën prej 5,940,563.13€ krahasuar me shpenzimet për periudhën e njëjtë të vitit 2022 në shumën prej 4,520,502.62 € janë më të larta për 31.41 % . Shpenzimet për paga dhe medijtje krahasuar me vitin paraprak janë më të larta për 14.26%, shpenzimet për mallra dhe shërbime janë më të larta për 36%, shpenzimet për shërbime komunale janë më të larta për 67.98 %, shpenzimet për subvencione janë më të larta për 13.15 % dhe shpenzimet kapitale janë më të larta për 130.98 %.

5. Shpenzimet buxhetore për periudhën janar-qershor 2023, raportit të shpenzimeve analitike sipas kodeve buxh

Nr.	Kodi ekon.	Përshkrimi	Shpenzimet janar-qershor /2023	Shpenzimet janar-qershor/2022	Ndryshimi
1	11110	PAGAT NETO PERMES LISTAVE	3.069.508.49	2.674.593.39	394.915.10
2	11115	PAGESA PËR SINDIKATË	6.119.82	13.878.24	(7.758.42)
3	11125	ANTARSIM-ODA E INFERMIERVE TE KOS.	1.165.61	1.224.00	(58.39)
4	11126	ANTARSIM-ODA E MJEKVE TE KOSOVËS	2.240.00	1.920.00	320.00
5	11400	PUNT. ME KONTRATË (JO NE LISTEë Të Të PAG.)	1.787.93	2.342.28	(554.35)
6	11500	TATIMI NE TARDHURA PERSONALE	200.108.39	160.833.30	39.275.09
7	11600	KONTRIBUTI PENSIONAL I PUNETORI	171.990.55	147.930.95	24.059.60
8	11700	KONTRIBUTI PENSIONAL I PUNEDHENSI	171.990.55	147.930.95	24.059.60
9	11900	PAGESA PËR VENDIME GJYQËSORË		21.793.75	(21.793.75)
	TOTALI:	RROGAT DHE PAGAT	3.624.911.34	3.172.446.86	452.464.48
10	13130	SHPEN.UDHTIMIT BRENDA	27.226.63	22.035.20	5.191.43
11	13141	SHPEN.UDHTIMIT JASHT VENDIT- meditet	572.00		572.00
12	13310	SHPENZ. PËR INTERNET	1.218.57	867.21	351.36
13	13320	SHPENZ.E TELEFONIT-VALA 900	6.634.03	7.524.02	(889.99)
14	13330	SHPENZIMET POSTARE	947.50	6.920.32	(5.972.82)
15	13430	SHËRBIME TË NDRY SHME SHËNDETËSORE	95.108.20		95.108.20
16	13440	SHERBIME TE NDRY SHME INTELEKTUALE DHE KES	-	150.00	(150.00)
17	13450	SHËRBIME SHTYPJE - JO MARKETING	7.889.42	9.976.42	(2.087.00)
18	13460	SHERB.KONTRAKTUESE TJERA	133.075.68	189.040.05	(55.964.37)
19	13470	SHERBIMET TEKNIKE	800.00	800.00	-
20	13480	SHPENZIMET PËR ANTARËSIM	10.617.00	1.500.00	9.117.00
21	13490	SHERBIMET E VARRIMIT	840.00	1.265.00	(425.00)
22	13501	MOBILJE (ME PAK SE 1000 Euro)	-	4.906.60	(4.906.60)
23	13503	KOMPJUTER ME PAK SE 1000 EURO	11.994.43	7.907.50	4.086.93
24	13506	PAJISJE SPECIALISTIKE MJEKËSORE <1000	-		-
25	13509	PAJISJE TJERA<1000 EURO	11.462.99	9.446.87	2.016.12
26	13610	FURNIZIME PERZYRE	15.361.41	13.823.85	1.537.56
27	13620	FURNIZIM USHQIM&PJE(JO DREKA)	44.848.94	40.820.59	4.028.35
28	13630	FURNIZIME MJEKSORE	31.311.53	27.732.20	3.579.33
29	13640	FURNIZIM PASTRIMI	5.996.14	6.548.91	(552.77)
30	13650	FURNIZIM ME VESHMBATHJE	901.00		901.00
31	13710	VAJ	-		-
32	13720	NAFT PER NGROHJE QENDRORE	3.839.01	19.994.01	(16.155.00)
33	13750	QYMYUR	4.638.66		
34	13760	DRU	64.260.84	62.136.55	2.124.29
35	13770	DERIVATE PER GJENERATOR	758.54	765.06	(6.52)
36	13780	KARBURANTE PER VETURA	24.586.11	33.483.07	(8.896.96)
37	13810	AVANC PËR PARA TE IMËT(PETTY CASH)	1.000.00		1.000.00
38	13820	AVANC PËR UDHËTIME ZYRTARE	572.00		572.00
39	13920	PROVIZIONI BANKAR I BKT	-	30.00	(30.00)
40	13950	REGJ.SIGURIMI I AUTOMJETEVE	1.430.00	1.030.00	400.00
41	13951	REGJ.SIGURIMI I AUTOMJETEVE	3.460.28	2.768.59	691.69

42	13953	SIGURIMI I NDËRTESAVE TJERA	1.260.24		
43	14010	MIRM.RIPARIMI I AUTOMJETEVE	9.364.12	10.977.32	(1.613.20)
44	14020	MIRMBAJTJA E NDERTESAVE	5.204.92	426.81	4.778.11
45	14023	MIRMBAJTJA E SHKOLLAVE	24.754.64	13.185.53	11.569.11
46	14024	MIRËMBAJTJA OBJEKTEVE SHËNDETËSORE	-	983.00	(983.00)
47	14032	MIRËMBAJTJA AUTO RRUGËVE LOKALE	212.363.65	44.099.18	168.264.47
48	14040	MIRËMBAJTJA E TEKNOLO. INFORMATIVE	990.00	397.63	592.37
49	14050	MIRMB.PAISJEVE DHE MOBILEVE	26.824.30	12.550.10	14.274.20
50	14060	MIREMBAJTJA RUTINORE	6.987.50	5.665.50	1.322.00
51	14120	QIRAJA PËR TOKË	1.294.00		
52	14210	REKLAMAT DHE KONKURSET	1.200.00	900.00	300.00
53	14230	SHPENZ.PER INFORMIM PUBLIK	2.120.00		2.120.00
54	14310	DREKAT ZYRTARE	2.064.81	1.482.20	582.61
55	14410	SHPENZIME-VENDIMET E GJYKATAVE	47.20	30.374.90	(30.327.70)
	TOTALI: 13	MALLRA DHE SHERBIME	805.826.29	592.514.19	213.312.10
56	13210	RRYMA	88.282.28	77.820.26	10.462.02
57	13220	UJI	9.988.17	4.349.00	5.639.17
58	13230	MBETURINAT	48.313.45	5.569.94	42.743.51
59	13250	SHPENZIMET TELEFONIKE	2.708.82	1.134.45	1.574.37
	TOTALI: 14	SHPENZIMET KOMUNALE	149.292.72	88.873.65	60.419.07
60	21110	SUB. PER ENTITETE PUBLIKE	500.00	500.00	-
61	21200	SUB.PER ENTITETET JOPUBLIKE	171.721.35	151.706.90	20.014.45
	TOTALI: 2	SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	172.221.35	152.206.90	20.014.45
62	31120	NDERT. E ADMIN. AFARISTE	84.900.00	16.398.36	68.501.64
63	31121	OBJEKTET ARSIMORE	14.312.39	16.044.00	(1.731.61)
64	31122	OBJEKTET SHËNDETËSORE	-		-
65	31124	OBJEKTET SPORTIVE	-		-
66	31129	FUSHAT SPORTIVE	-		-
67	31230	NDERTIMI I RRUGEVE LOKALE	870.151.70	288.536.43	581.615.27
68	31240	TROTUARET	120.000.00		
69	31250	KANALIZIMI	1.494.84	54.396.09	(52.901.25)
70	31260	UJËSJELLËSI	27.452.50	21.000.00	6.452.50
71	31270	MIREMBAJTJA INVESTIVE	10.000.00	36.908.08	(26.908.08)
72	31510	FURNIZIMI ME RRYMË GJENRATOR TRAFNS	50.000.00		50.000.00
73	31660	PAJISJE SPECIALE MJEKËSORE	-		-
74	31690	PAJISJE TJERA	-		-
75	32000	INVESTIMET NË VUJIM	-	65.095.10	(65.095.10)
76	32120	PARQET NACIONALE	10.000.00		
77	32110	RREGULLIMI I LUMEJVE	-	11.082.90	(11.082.90)
78	32111	SISTEMI I UJITJES	-		-
79	33200	TRANSFERE KAPITALE – ETNITETE JO PUBLIK	-	5.000.00	(5.000.00)
	TOTALI: 3	PASURIT JO FINANCIARE	1.188.311.43	514.460.96	543.850.47
TOTALI I PERGJITHSHEM:11,13,14,20,30			5.940.563.13	4.520.502.56	1.290.060.57


Klinë, 4.04.2023
Financiare

Zyrtarja Kryesore

Melihate Behramaj




Republika e Kosovës / REPUBLIC OF KOSOVO Zyra Kombëtare e Auditimit / NATIONAL AUDIT OFFICE NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
23.06.2023			
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shif. Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages
04	47	1033	1



Republika e Kosovës
 Republika Kosova
 Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
 Nacionalna Kancelarija Revizije
 National Audit Office

Per:	Zenun Elezaj , Kryetar i Komunës së Klinës Fadil Gashi, Kryetarin e Kuvendit Komunal të Komunës së Klinës Glauk Konjufca, Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës
Kopje elektronike:	Hykmete Bajrami, Kryetare e KMFP Armend Muja, Kryetar i KBPT
Nga:	Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme e Republikës së Kosovës 
SUBJEKTI:	Raporti i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Klinës për vitin 2022.

Nr. Zyrës:	Ext:	Data: 22.06.2023
------------	------	------------------


Data	Zyra e Pranimi	Komentet/Veprimet	Inicialet	Afati
		<p>Bashkangjitur mund të gjeni Raportin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Klinës për vitin 2022.</p> <p>Sipas nenit 23, pika 5 të Ligjit nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, brenda 30 ditësh nga dita e pranimi të raportit final të auditimit, çdo institucion i audituar është i obliguar ta dorëzoj një Plan Veprimi ku përcakton se si do t'i adresoj rekomandimet e dhëna në raport.</p>		

Handwritten text, possibly a signature or initials, located on the left side of the page.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE PRANISORORIELLAZ DATUM PRINIZH POSTAVLJEN UNTERRECHTEN SURINNEVEN			
23.06.2023			
Nr. Sisa Org. Jedin. Org. Unif.	Shif. Klasiif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i Faqeve Br. Stranica No. Pages
04	47	1033	1



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Za:	Zenun Elezaj, Predsednik Opštine Fadil Gashi, Predsednik Skupštine opštine Glauk Konjufca, Predsednik Skupštine Republike Kosovo
Elektronski primerak:	Hykmete Bajrami, Predsednik KNJF Armend Muja, Predsednik KBRT
Od:	Vlora Spanca, Generalna Revizorka Republike Kosovo
PREDMET:	Izveštaj o reviziji godišnjih finansijskih izveštaja za 2022 godinu.

Br. Kancelarije: No. de bureau:	Ext: Poste:	Datum: 22.06.2023
------------------------------------	----------------	-------------------

Datum	Prijemna kancelarija	Komentari/Radnje	Inicijali	Rok
		<p>U prilogu možete pronaći Izveštaj revizije za godišnje finansijske izveštaje za 2022 godinu.</p> <p>Prema članu 23, stav 5 Zakona br. 05/L-055 o Generalnom Revizoru i Nacionalnom Kancelariju Revizije, svaka revidirana institucija je obavezna da u roku od 30 od dana prijema završnog izveštaja podnese Akcioni Plan u kojem se određuje kako će adresirati preporuke koje su date u izveštaju.</p>		

Handwritten scribble or signature in blue ink, possibly containing the word "Security".



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË KLINËS PËR VITIN 2022

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2023

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Klinës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Klinës (KK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Klinës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Vlera e pasurisë jo kapitale mbi 1,000€ e prezantuar në PVF ishte mbivlerësuar për 844,314€.
- B1 Klasifikimi i shpenzimeve është bërë në kategori ekonomike jo adekuate në vlerë 34,158€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Klinës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A2 Zotimi i Mjeteve financiare pas pranimit të faturave dhe situacioneve të punëve të kryera.
- A3 Komuna kishte dhënë subvencione në kundërshtim me Rregulloren për Subvencionimin e OJQ-ve dhe me kriteret e përcaktuara në Thirrjet Publike.
- B2 Komuna ka kryer pagesa me vonesë në vlerë prej 26,652€, si dhe ka pasur pagesa direkte nga Thesari në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbarimore për paga jubilarë dhe përcjellëse në vlerë prej 54,749€.
- C1 Komuna me rastin e thirrjes publike për subvencionim të OJQ-ve nuk kishte respektuar afatin ligjor të publikimit që kërkohet me rregullore.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbarimin e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Klinës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Klinës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Klinës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Klinës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislati i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësim ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësim ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Klinës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të dukshme, rreth menaxhimit financiar dhe Kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: keq klasifikim e shpenzimeve, subvencionimi i fermerëve në kundërshtim me thirrjen publike, mangësi në regjistrat e pasurive, vonesa në pagesën e faturave, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 12 rekomandime, prej tyre pesë (5) janë rekomandime të reja, tri (3) të përsëritura dhe katër (4) pjesërisht të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Mbivlerësimi i pasurisë jo financiare

Gjetja

Rregullorja MF-nr.02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton qartë rregullat dhe procedurat për menaxhimin e pasurive dhe stoqeve.
Gjithashtu Neni 6 i rregullës MF nr.01/2017 për Raportimin vjetor financiar nga OB përcakton që - Organizatat Buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare.

Në pesë (5) raste në vlerë 844,314€ investimet e bëra ndër vite për qytetarët, Komuna i kishte regjistruar në regjistrin e pasurisë edhe pse nuk janë në pronësi të Komunës, me ç'rast pasuritë e komunës ishin mbivlerësuar. Rastet kanë të bëjnë me ndërtimin e shtëpive në fshatin Berkove, 625,414€, participimi në fabrikën e Ujit-në Klinë 45,000€, ndërtimi i shtëpive Rudice 72,857€, fasadimi i objekteve në Rr. Dëshmorët e kombit, 88,326€ dhe furnizim me sera për partneret bujqësor 12,717€.

Shkaqet e kësaj qëndrojnë për faktin se, Komuna nuk ka rishikuar apo azhurnuar regjistrin e pasurisë e që rezulton me mosfunksionim të duhur të kontrolleve të brendshme lidhur me menaxhimin e pasurisë.

Ndikimi

Regjistri i pa saktë, tregon menaxhim të dobët të pasurisë, si pasoj, ka ndikuar në mbivlerësimin e pasurive si dhe në prezantimin jo të drejtë të pasurisë në pasqyra financiare.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të siguroj se regjistri i pasurive është azhurnuar në mënyrë që i njëjti të përmban vetëm pasuritë në pronësi të komunës. Po ashtu, të siguroj se vlera e pasurisë e prezantuar në PFV-të e komunës është e saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B1 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF "Mbi shpenzimin e parasë publike" shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Komuna kishte bërë keq klasifikime të shpenzimeve, ku nga kategoria ekonomike investime kapitale, kishte paguar 34,158€, që për nga natyra i takojnë subvencioneve dhe tansferëve. Shpenzimet e paguara kanë të bëjë me, fuqizimin dhe punësimin e të rinjve, fuqizimin socio-ekonomik të Ballkanit perëndimor.

Kjo ka ndodhur si pasojë e planifikimit të gabuar të shpenzimeve gjatë hartimit të buxhetit nga ana e Komunës dhe aprovimit të buxhetit nga Ministria e Financave.

Ndikimi Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve ndikon në mbivlerësim/nënvlerësim të shpenzimeve në kategori të ndryshme si dhe prezantim jo të saktë të shpenzimeve në PFV.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A2 - Zotimi i mjeteve financiare pas pranimit të faturës

Gjetja Sipas Rregullës Financiare nr. 01/2013/MF - shpenzimi i parasë publike, neni 22, hapat për procedim të pagesave janë: kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, procedohet urdhër blerja, raporti i pranimit të mallit apo shërbimit, pastaj behet pranimi i faturës, tutje certifikohet/ekzekutohet pagesa në fjalë.

Nga testimi i pagesave të punëve të kryera të projekteve kapitale, kemi hasur në tri (3) raste të pagesave në vlerë 168,430€ që janë realizuar pa u zbatuar procedurat e duhura. Pra janë pranuar mallra, shërbime dhe faturat para së të behet zotimi i mjeteve. Rastet kishin të bënin me:

- "Renovimi i objekteve shkollore dhe fushave sportive " në vlerë 54,203€, zotimi i mjeteve dhe urdhër blerja ishin bërë pas pranimit të faturës (me 24.10.2022, ndërsa fatura e datës 07.10.2022 ishte protokolluar me datë 10.10.2022);
- "Asfaltimi i rrugëve dhe infrastrukturës Klinë-Dresnik-Dollc " në vlerë 61,514€, zotimi i mjeteve dhe urdhër blerja ishin bërë me datë 21.09.2022 , ndërsa fatura dhe raporti i menaxherit të kontratës ishin me datë 15.09.2022; dhe
- "Punë shtesë në projektin e asfaltimit të rrugëve Stupë - Zajm " në vlerë 52,713€, zotimi i mjeteve ishte bërë me datë 19.10.2022, ndërsa fatura ishte e datës 22.09.2022.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme dhe hyrjeve në obligime pa siguruar mjete të mjaftueshme për projekte të caktuara.

Ndikimi Zotimi i mjeteve pas pranimit të faturave, përveç së nuk është në pajtim me kërkesat e rregullës financiare, mund të ndikoj që të pranohen punë të kryera me shumë sesa ka mjete buxhetore, rrjedhimisht mund të krijohen vështirësi dhe vonesa për pagesë.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë se janë forcuar kontrollet e brendshme në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procedimi i pagesave duhet të bëhet sipas kronologjisë së ngjarjeve dhe në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me rregullën financiare për shpenzimin e parave publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Subvencionimi i fermerëve në kundërshtim me Thirrjet Publike

Gjetja Sipas dy Thirrjeve Publike për subvencionimin e fermerëve me Sera (63,950€) dhe me Makina Mjelëse (7,290€) të shpallura me datën 23.02.2022, midis tjerash kërkohej që përfituesi të jetë banor i Komunës; të posedojë sipërfaqe të mjaftueshme të tokës për vendosjen e serës; të ketë mundësi ujitjeje (posedojë bunar); të jetë i gatshëm që të marrë pjesë me 30 % të mjeteve financiare në koston e serës; të merret me kultivimin e blegtorisë; të posedojë së paku 2 krerë lopë qumështore apo 20 krerë dele apo dhi të mbarësuar.

Gjatë shqyrtimit të procesit të vlerësimit të dy thirrjeve publike kemi vërejtur se komisioni i vlerësimit në formularin e poentimit ka përdorë kritere të cilat nuk kanë qenë të përfshira në asnjërin prej Thirrjeve Publike, si numri i anëtarëve familjar, statusi i punësimit, gjendja ekonomike, përmes së cilave kritere të pashpallura janë fituar pikë dhe janë vlerësuar përfituesit. Për më tepër, në lidhje me këtë çështje ne kemi testuar tetë (8) përfitues dhe Komisioni Vlerësues nuk kishte siguruar dëshmi fizike për asnjërin prej tyre, se kanë përbushur kriteret e pashpallura, si numri i anëtarëve familjar, statusi i punësimit, apo gjendjen ekonomike.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mosrespektimit të kriterëve të shpalljes publike nga ana e komisionit vlerësues.

- Ndikimi** Subvencionimi i fermerëve duke përdorur kritere të cila nuk kanë qenë të shpallura në Thirrje dëmton transparencën dhe shfaqë dyshime në tërë procesin, pasi që janë përdorur kritere që nuk kanë qenë të shpallura në Thirrjet Publike, për të cilat aplikuesit nuk kanë qenë të njoftuar.
- Rekomandimi A3** Kryetari duhet të sigurojë se para se të bëhen shpalljet e thirrjeve publike për subvencionim të fermerëve, të bëhet një analizë e mirëfilltë e kriterëve në mënyrë që ato të shpallen dhe Komisionet e Vlerësimit të vlerësojnë aplikacionet me përpikëri të plotë kundrejt tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Vonesa në pagesën e faturave dhe shpenzimet shtesë të procedurave

- Gjetja** Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për LMFPP, Çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. Ndërsa, sipas nenit 40, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrat të prerë nga gjykata/përmbaruesi.

Nga testimi i pesë (5) mostra në vlerë gjithsej 26,652€ kemi vërejtur se komuna me vonesë kishte kryer pagesat duke tejkaluar afatin ligjor për pagesë. Vonesat lëvizin nga 47 deri në 127 ditë.

Më tutje nga rishikimi i pagesave të obligimeve kemi vërejtur se Thesari ka ekzekutuar pagesa direkt në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbarimore për pagesën e kompensimeve të punëtorëve, si rezultat i kontratës kolektive, si dhe për dy OE për mos pagesë të borgjit në vlerë gjithsej prej 54,749€.

Mos pagesa e obligimeve me kohë, ka ndodhur për shkak hyrjes në obligime financiare pa pasur mjete buxhetore të planifikuara dhe mangësive në menaxhimin e obligimeve. Derisa mos pagesa e obligimeve me kohë sa i përket pagave ka ndodhur për shkak të mungesës së mjeteve për shlyerjen e obligimeve të dala nga kontrata kolektive.

- Ndikimi** Hyrja në obligime pa zotimin me kohë të mjeteve financiare, si dhe mos pagesa e faturave dhe obligimeve me kohë e ekspozon Komunën ndaj padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë

gjyqësore/përmbarimore dhe të kamatave.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha faturat dhe obligimet të paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmbarimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Mos aplikimi i plotë i Rregullores për Subvencionim të OJQ-ve

Gjetja Rregullorja e MF - Nr - 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, përcakton se: Thirrja duhet të jetë e hapur për së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë pune (Neni 12.3); Secili nga anëtarët e Komisionit Vlerësues, para vlerësimit nënshkruan deklaratën mbi paanshmërinë dhe konfidencialitetin (Neni 16.2); Komisioni Vlerësues në mbledhjen e tij të parë miraton rregullat e punës (Neni 8.6); Të mos ketë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete (Neni 10.1.5).

Thirrja Publike e datës 10.05.2022, për mbështetje financiare për vitin 2022 për të gjitha Organizatat Jo-Qeveritare në Komunën e Klinës, ishte mbajtur e hapur deri më 18.05.2022, apo shtatë ditë dhe jo 15 ditë, ndërsa anëtarët e Komisionit nuk kishin nënshkruar deklaratën mbi paanshmërinë dhe konfidencialitetin, nuk kishin miratuar rregullat e punës, dhe nuk kanë aplikuar formularin mbi burime tjera të financimit.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme që ka rezultuar me mos respektim të kërkesave të Rregullores së lartpërmendur.

Ndikimi Mangësitë e listuara, dëmtojnë konkurrencën, paanshmërinë, transparencën, dhe paraqesin rrezik që fondet e dhëna të mos jepen për përfitueset meritore dhe për qëllimet e duhura.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të shtojë kontrollet për të siguruar se zyrtarët të cilët janë përfshirë në proceset e dhënies së subvencioneve të jenë të informuar mirë në lidhje me kërkesat e Rregullores, në mënyrë që të mos përsëriten lëshimet e sipërpërmendura dhe të aplikohet me përpikëri të plotë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Klinës në vitin 2022 në total ishin 1,208,535€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Përveç të hyrave të realizuara nga Komuna të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme, Komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte që janë realizuar nga niveli qendror (gjobat e gjykatave, gjobat pyjore dhe dënimet e trafikut) në vlerë totale prej 433,302€.

Çështja C2 - Mangësi në bazën e të dhënave të tatimpaguesve në pronë

- Gjetja** Ligji Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme , Neni 12, thekson se komuna ka përgjegjësi për regjistrim dhe menaxhim të të dhënave të tatimit në pronë në regjistrat e tatimit në pronë ashtu siç përcaktohet në aktin nënligjor.
- Nga të dhënat e tatimit në pronë, është identifikuar se 528 tatimpagues të evidentuar në këtë bazë, nuk kanë të prezantuar numrat personal, të cilët në bazë të emrave, mbiemrave dhe emrit të prindit, mund të jenë potencialisht përfitues të disa hershëm nga zbritja e lejuar ligjore.
- Kjo ka ndodhur si rrjedhojë e mos verifikimit të pronave në fjalë dhe mos azhurnimit të shënimeve në sistemin e tatimit në pronë i cili sistem poashtu për shkak të mangësive lejon regjistrimin pa numër identifikues.
- Ndikimi** Mungesa e të dhënave në data bazë për numrat personal të tatimpaguesve mund të ndikojë në përfitim të paligjshëm të disa hershëm të tatimpaguesve, të zbritjes së lejuar për vendbanim parësor.
- Rekomandimi C2** Kryetari duhet të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar që baza e të dhënave të tatimit në pronë plotësohet me të gjithë numrat personal të tatimpaguesve, ashtu që të mundësohet verifikimi i të gjitha rasteve potenciale që mund të hasen me përfitim të disahershëm për vendbanim parësor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 4,050,693€ prej tyre në 2022 ishin shpenzuar 3,197,368€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me ndërtimin dhe rregullim të infrastrukturës rrugore, ujësjellësit dhe kanalizimeve, ndërtim të objekteve sportive/kulturo, parqeve, blerje të pajisjeve si dhe përmirësime të ndryshme të kapitalit.

Çështja B3 - Mos-nënshkrimi i planit të menaxhimit të kontratës nga palët kontraktuese

Gjetja Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, pika 61.8 përcaktojnë se plani për menaxhimin e kontratës do të përgatitet para fillimit të zbatimit të kontratës dhe me pajtimin e palëve të kontratës, kjo do të dokumentohet me nënshkrimet e të dyja palëve, përkatësisht, menaxherit të kontratës nga ana e Autoritetit Kontraktues dhe menaxherit të kontratës nga ana e Operatorit Ekonomik.

Nga testimi i pesë (5) lëndëve për qëllime të pajtueshmërisë me procedura kemi gjetur se kishte mangësi me planin e menaxhimit të kontratës. Në tre (3) raste plani i menaxhimit të kontratës nuk është nënshkruar fare, ndërsa në një (1) rast plani është nënshkruar vetëm nga operatori Ekonomik e jo edhe nga Autoriteti Kontraktues.

Kjo ka ndodhur për shkak të neglizhencës së menaxherëve të kontratave, të cilët nuk kanë përfillur kërkesën e rregullave që t'i nënshkruajnë planet e menaxhimit të kontratave.

Ndikimi Mos-nënshkrimi i planeve përkatëse të menaxhimit të kontratave nga palët kontraktuese, shfaqë mungesë përgjegjësie nga zyrtarët komunal dhe nuk konfirmon që plani i menaxhimit në të vërtetë është dakorduar nga të dyja palët, dhe kjo ndikon që të ndodhin vonesa në ekzekutimin e punëve.

